



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:217439

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05739205

Ac.nr.6515/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Liridon Maloku anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: Z.N.M. nga M....., të cilën e përfaqëson me autorizim avokati Avni Leci nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj” lamela A, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 10,037.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës dhe përgjigjes në ankesë së paditëses, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.655/15 i datës 26.02.2021, në seancën jo publike të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës: Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj” lamela A, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.655/15 i datës 26.02.2021, në pikën I dhe II të dispozitivit, VERTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën III, në pjesën refuzuese të kërkesëpadiisë për sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.655/15 i datës 26.02.2021, ka vendosur që të:

I. APROVOHET kërkesëpadiia e paditëses Z.N.M. nga M....., andaj OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit ti paguaj dhe atë

Në emër të dëmit jo material:

-Në emër të dhimbjes fizike të shkaktuar, shumën prej 3,150.00 euro;

-Në emër të dhimbjes shpirtërore të përjetuar për shkak të frikës, shumën prej 2,800.00 euro;

-Në emër të përjetimit të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit në shkallë prej 3%, shumën prej 2,000.00 euro;

-Në emër të përjetimit të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit, shumën prej 1,500.00 euro.

Në emër të dëmit material:

-Në emër të dëmit material për ndihmë të personave tjerë për 14 ditë shumën prej 140.00 euro;

-Në emër të ushqimit të përforcuar për 21 ditë, shumën prej 210.00 euro;

-Në emër të harxhimeve për mjekim, shumën prej 55.00 euro.

E gjithë kjo me kamatë ligjore në nivel vjetor prej 12%, duke filluar nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim të dëmit data 23.02.2015 e deri në pagesën përfundimtare, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. OLIGOHET e paditura Kompania e sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që paditëses Z.N.M. nga M....., në emër të harxhimeve procedurale ti kompensoj shumën prej 811.40 euro, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET kërkesa e paditëses Z.N.M. nga M....., për shumën përtej shumës së gjykuar prej 811.40 euro, e deri te shuma e kërkuar 1,088.80 euro, në emër të kompensimit të harxhimeve të procedurës kontestimore, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t’ia kthej në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse, e cila propozon që të refuzohet si e pa themeltë ankesa e palës së paditur, kurse aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Z.N.M. nga M..... rr....., përmes të autorizuarit të saj kishte paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë me datë 23.11.2015, kundër të paditurës të precizuar si në kërkesëpadi, ku gjatë procedurës i autorizuari i paditëses ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura që në emër të përjetimit të dhimbjeve fizike ti paguaj shumën prej 3,100.00 euro, në emër të dhimbjes shpirtërore dhe frikës shumën prej 2,800.00 euro, në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallën prej 3% shumën prej 2,000.00 euro, në emër të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit shumën prej 1,500.00 euro, në emër të dëmit material për kujdes nga personat e tjerë për 14 ditë shumën prej 140.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar për 21 ditë shumën prej 210.00 euro, në emër të rehabilitimit fizikal në banjë shumën prej 182.00 euro, në emër të harxhimeve të shërimit shumën prej 55.00 euro, që në total mbërrin shuma prej 10,037.00 euro. Kurse, për sa i përket pjesës tjetër të dëmit, nga siguruesi i drejtuesit të automjetit “B” në rastin konkret, me të cilin paditësja ka qenë brenda në automjet, V.B., paditësja thotë se e ka realizuar në procedurë të rregullt.

Paditësja ka kërkuar gjithashtu dhe kompensimin për harxhimet e procedurës, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për përfaqësim në dy shqyrtime shumën prej 540.00

euro, në emër të pagesës për ekspertizën mjekësore shumë prej 300.00 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 40.00 euro, për të cilat ka dorëzuar dhe provat.

Në anën tjetër, e paditura në përgjigjen në padi si dhe gjatë procedurës pjesërisht e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses sipas lartësisë dhe bazës së kontestit. Gjithashtu, e paditura verbalisht ka ofruar kompensimin për dëmin jo material në shumë prej 60% për të siguruarin dhe paditësen, kurse 40% i takon Kompanisë së Sigurimeve “Kosova e Re”.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.655/15, i datës 26.02.2021, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: nga Raporti i Policisë së Kosovës të datës 18.01.2015 është vërtetuar se në të njëjtën ditë ka ndodhur aksidenti mes tri automjeteve në magjistralen F....- P....., ku automjeti A i markës “OPEL CORSA” me numër të targave 05.....për tu kyçur në magjistrale ka kaluar në anën e kundërt të korsës (anën e majtë), ku lëvizte automjeti B i markës “RENAULT CLIO” me numër të targave 02....., të cilin e voziste V.B., i cili për të shmangur aksidentin kaloi në anën e djathtë të korsës dhe me këtë rast goditi automjetin C të markës “FIAT PUNTO” me numër të targave 01..... Si pasojë e kësaj është shkaktuar dëm material si dhe shumë persona kanë mbetur me lëndime trupore.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se sigurues i automjetit A është Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, kurse sigurues i automjetit B është Kompania e Sigurimeve “KOSOVA E RE”.

Sipas gjetjes dhe mendimit të ekspertit gjyqësor të trafikut B.S.me datë 27.04.2015, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se aksidenti a ndodhur për shkak se automjeti A nuk kishte përshtatur shpejtësinë me kushtet në rrugë dhe duke dashur të kyçet në magjistrale, nga moskujdesi direkt ka kaluar në korsën e majtë të rrugës, ku po lëvizte makina B e cila për t’iu shmangur aksidentit doli në korsën e djathtë ku dhe goditi makinën C në pjesën e përparme të anës së majtë, pasi që dhe makina C po kyçej në magjistrale. Sipas ekspertit të trafikut, këtu lëshimin primar e ka bërë vozitësi i makinës A, I.B., kurse lëshimin sekondar e ka bërë vozitësi i automjetit B, V.B..

Duke u bazuar në raportin e oftamologut me datë 19.01.2015, dy raporteve të Spitalit Regjional në Mitrovicë të datave 21 dhe 22 Janar 2015, raportit të Ordinancës Specialistike “Orthopedia” të datës 21.01.2015, udhëzimit për hulumtime diagnostifikuese 22.01.2015 dhe raportit të poliklinikës “Kavaja” të datës 22.01.2015, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja ka pësuar lëndime trupore, dhe atë: thyerje të kockave të hundës, septumit hematomik të hundës, gjakderdhje dhe ndrydhje dhe zhvendosje në pjesën e qafës dhe boshtit kurrizor.

Duke u bazuar në gjetjet dhe mendimet e ekspertit- vlerësimit mjekësor të Klinikës Ortopedike dhe Psikiatrike të “QKUK”, të datës 12.03.2020, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se lëndimet që ka marrë paditësja konsideron lëndime të rënda trupore.

Që nga momenti i shkaktimit të dëmit e deri kur ka mbërritur në spital, paditësja ka pasur dhimbje me intensitet të lartë për 30 minuta dhe tri ditë pas shkaktimit të dëmit. Pastaj dhimbje me intensitet të mesëm ka pasur tri javë pas shkaktimit të dëmit, dhe dhimbje me intensitet të ulët ka pasur dhe dy javë tjera më pas. Eksperti ka konstatuar se sipas dokumentacionit mjekësor dhe bisedave me paditësen, e njëjta ka pasur frikë primare nga vdekja dhe kërcënim direkt të integritetit në momentin e aksidentit, kurse frikë sekondare ka pasur pas aksidentit, e si pasojë e kësaj ajo ka pasur probleme me gjumin, kujtime të ngjarjes, frikë nga invaliditeti, çrregullime të disponimit dhe probleme tjera të cilat i kanë zgajtur 3-6 muaj pas aksidentit, të gjitha këto me intensitet të mesëm dhe të ulët. Paditësja edhe sot ndjen frikë me intensitet të mesëm gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, si dhe ka pasoja të shëmtimit dhe dhimbje në zonën e hundës dhe

shpinës, pasi që nuk ka pasur thyerje të eshtrave. Ekziston zvogëlim i përgjithshëm i aktivitetit jetësor prej 3%, sipas Rregullores për dëm jo material të Ministrisë së Shëndetësisë të vitit 2016, dhe konsiderohet se ka konsumuar ushqim të përforcuar për tri javë, si dhe ka pasur nevojë për kujdes nga personat e tjerë për dy javë që ti përmirësohet shëndeti, si dhe shkuarje në rehabilitim në banjë për një javë.

Gjykata e shkallës së parë me këtë rast ka konstatuar përmes kuponave fiskal dhe kontrollat e kryera mjekësore, të cilat së bashku mbërrijnë shumën prej 55.00 euro.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja kishte dërguar tek e paditura kërkesë për kompensimin e dëmit material dhe jo material me datë 23.02.2015, por kësaj kërkesë e paditura nuk i është përgjigjur, dhe si rrjedhojë paditësja ka fituar të drejtën për mbrojtje gjyqësore pranë gjykatës.

Gjykata e shkallës së parë ka pranuar në tërësi të gjitha provat me shkrim, duke i vlerësuar si të qarta dhe të besueshme, dhe aq më shumë me deklaratat e palëve të cilat as nuk janë vënë në pyetje e as nuk janë kontestuar.

Gjykata e shkallës së parë, për marrjen e vendimit si në dispozitiv të aktgjykimit është bazuar në nenin 9 të Ligjit për Marrëdhënie Detyimore (tutje LMD), ku parashihet se:” *Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit.*”

Dispozitat sipas nenit 137 të LMD-së parasheh se:” *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*”

Sipas nenit 183 paragrafi 1 të po këtij ligji, përcaktohet se:” *Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.*”, kurse sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se:” *Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.*”

Me dispozitën e nenit 170 parashihet se:” Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimeve të dëmit.”

Me dispozitat e nenit 25 paragrafi 1 parashihet se:” *I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të auto përgjegjësive t’ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës.*” Kurse, sipas nenit 26 paragrafi 1 të të njëjtit ligj parashihet se:” *Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar.*” Paragrafi 5 i këtij neni parasheh se:” *Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.*”

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike ku sipas nenit 137 të LMD-së është vërtetuar që paditësja ka pësuar dëm material dhe jo material, dhe atë bazuar në nenin 9 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia parashihet se:” *Sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i*

mjetit motorik.” Nga gjendja faktike është vërtetuar se e paditura është siguruese e automjetit A, pronar i të cilit është I.B., e i cili është përgjegjës për këtë aksident në trafik.

Nga ekspertiza e dhënë nga eksperti i trafikut rrugor shihet qartë se përgjegjësinë primare e ka vozitësi i automjetit A, I.B., i siguruar i të cilit është Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, në këtë çështje civile e paditura. Gjersa kjo e fundit e ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke u thirrur në përgjegjësinë sekondare të vozitësit të automjetit B, i siguruar i të cilit është Kompania e Sigurimeve “KOSOVA E RE”. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se Kompania e Sigurimeve “KOSOVA E RE” ka paguar pjesën e vet të kompensimit ndaj paditëses, siç ishte kërkuar 40% të pjesës së dëmit. Përderisa është konstatuar se e paditura nuk ka vepruar njëjtë, duke paguar kompensimin prej 60% të dëmit të shkaktuar.

Bazuar në nenin 183 paragrafi 2 të LMD-së, ku përcaktohet se:” Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”, gjykata e shkallës së parë ka caktuar se në emër të në emër të dhimbjes fizike të shkaktuar duhet paguar shumën prej 3,150.00 euro, në emër të dhimbjes shpirtërore të përjetuar për shkak të frikës, shumën prej 2,800.00 euro, në emër të përjetimit të dhimbjes shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit në shkallë prej 3%, shumën prej 2,000.00 euro dhe në emër të përjetimit të dhimbjes shpirtërore për shkak të shëmtimit, shumën prej 1,500.00 euro.

Kurse bazuar në nenin 179 të LMD-së, ku përcaktohet se:” 1. *Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.*” Kurse, sipas nenit 2:” *Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t’i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.*” Në këtë rast, në emër të dëmit material për ndihmë të personave tjerë për 14 ditë duhet paguar shumën prej 140.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar për 21 ditë, shumën prej 210.00 euro, në emër të harxhimeve për mjekim, shumën prej 55.00 euro.

Lidhur me kamatën e përcaktuar nga gjykata në pikën I të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 382 paragrafi 2 të LMD-së, ku përcaktohet se:” *Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*”, lidhur me nenin 26 paragrafi 6 të Ligjit për Sigurim të Detyruar nga Auto përgjegjësia, ku parashihet se:” *Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.*”

Vendimi për shpenzimet e procedurës i cili ndodhet në pikën II të dispozitivit është marrë bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, ku përcaktohet se:” *Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.*”

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2,

pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugorë ka ndodhur me datë 18.01.2015, rreth orës 21:45 minuta, në “Veternik” Prishtinë, përkatësisht mbi urën e magjistrales Ferizaj-Prishtinë kishte ndodhur aksidenti mes tri automjeteve në magjistralen F....- P....., ku automjeti A i markës “OPEL CORSA” me numër të targave 05.....për tu kyçur në magjistrale ka kaluar në anën e kundërt të korsës (anën e majtë), ku lëvizte automjeti B i markës “RENAULT CLIO” me numër të targave 02....., të cilin e voziste V.B., i cili për të shmangur aksidentin kaloi në anën e djathtë të korsës dhe me këtë rast goditi automjetin C të markës “FIAT PUNTO” me numër të targave 01..... Shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit A i tipit “Opel Corsa”, me targa të regjistrimit 01-573-CS, ngjyrë e bardh, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte I.B. nga P....., i siguruari i këtu të paditurës, i cili ka përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti, ndërsa me përgjegjësi sekondar është drejtuesi i automjetit B V.B. i siguar te KS Kosova e Re. Paditësja pasgjere në autmojetin B si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime të rënda trupore, paditësja ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet, me marrëveshjen i ka dhene ofert me dt.30.07.2015, mirëpo paditësja duke mos qenë i kënaqur vetëm me shumën e ofruar ka vazhduar të kërkoj edhe kompensimin e shumave për format e tjera të dëmit. Sa i përket bazës juridike e paditura e ka pranuar ne shqyrtim gjyqësor përgjegjësia për 60%.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses, për 60 % të përgjegjësisë gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, neni 140 përcakton se: “ Fajësia eksiton kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit, vlerësoj se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimit të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 3 %, shkallën e shëmtimit trupor - shkalla e lehtë e shëmtimit në pjesën e dukshme të hundës si dhe rrethanat tjera si moshën e paditëses dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 183 të LMD-së, e duke marr parasysh ndarjen e përgjegjësisë 60 % për të paditurën.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material, për kujdesin dhe ndihmën e huaj dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësja ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 14 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditësh, të njëjtës i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumatat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar, e duke marr parasysh ndarjen e përgjegjësisë 60% për të paditurën.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit material për paditësen dhe atë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, ushqimin e përforcuar dhe për shpenzimet e mjekimit, Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit material për kompensimin e shpenzimeve për ushqim të përforcuar, si dhe ndihmës dhe kujdesit të huaj, është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se ka qenë e nevojshme që i njëjti të përdorë ushqim të përforcuar, me qëllim të rehabilitimit me të shpejtë dhe me të mirë, si dhe ka qenë i nevojshëm kujdesi i personit tjetër si dhe për shpenzimet e mjekimit

të cilat janë vërtetuar përmes faturave dhe kuponëve fiskal të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj kjo gjykatë vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Vendimi sa i përket kamatës është marrë në përputhje me dispozitën e nenit 26 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia prej 12%, për faktin se paditësja përmes të autorizuarit të tij me kërkesën e datës 23.02.2015, i është drejtuar të paditurës, KS “SIGURIA”, për lidhjen e marrëveshjes jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit për aksidentin e datës 18.01.2015, dhe se e paditura nuk e ka trajtuar kërkesën brenda afatit 60 ditor për demin jo material dhe për demin material nuk e ka trajtuar kërkesën brenda afatit 15 ditor, kjo vërtetohet nga kërkesa e pranuar nga e paditura me numër 173/15 datë 23.02.2015 dhe njoftimi i të paditurës me Nr.173b/15 datës 30.07.2015. Andaj, Gjykata e Apelit gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e kësaj kamate. Po ashtu kamata e vendosur në këtë mënyre është në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika III, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë sa i përket shpenzimeve të procedurës përtej shumes së gjykuar, nuk janë shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6515/2021, me datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v

Numri i lëndës: 2019:217439
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739205